

# KODI I SJELLJES SË PARTIVE POLITIKE SHQIPTARE

## GJATË FUSHATAVE ZGJEDHORE

*Ky “Kod Sjelljeje” u hartua në konsultim me partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Shqipërisë, ato që do të garojnë në Zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe në bashkëpunim mes Aleancës Kundër Urrejtjes (Avokati i Popullit - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimit - Këshilli shqiptar i medias dhe Autoriteti i Mediave Audio-vizive), Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe zyrës së Këshillit të Europës<sup>1</sup> (Në përputhje me Kushtetutën e R.SH,<sup>2</sup> legjislacionin në fuqi<sup>3</sup> dhe Rekomandimet e ECRI<sup>4</sup> ).*

### **Preambula**

Ne, Partitë politike nënshkruese,

Duke njohur përgjegjësinë e lartë ndaj Republikës së Shqipërisë, qytetarëve shqiptarë dhe të ardhmes së tyre;

Duke u përpjekur për zhvillimin paqësor dhe demokratik të vendit, dhe vendosur interesat kombëtare mbi interesat private dhe partiake;

Duke njohur dhe respektuar të drejtat themelore të njeriut të garantuara në Kushtetutën e R.SH, dhe të gjithë kuadrin ligjor në fuqi;

Të ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka një proces zgjedhor i drejtë, i lirë e i ndershëm, në respekt të parimeve të shtetit të së drejtës;

---

<sup>1</sup> Project for Anti-Discrimination Promotion of Diversity and Equality in Albania EU/CoE Horizontal Facility for the Western Balkans and Turkey II

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, e ndryshuar.

<sup>3</sup> Ligj Nr.10 221, Datë 4.2.2010 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, dhe Ligji Nr. 10 019, Datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Kodin Penal të R.SH.

<sup>4</sup> Publikuar nga: Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) Këshilli i Evropës - 2016 Shtypur në Strasburg. <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech-alba/16809eb58e>

Duke vlerësuar se zbatimi i standardeve më të mira demokratike ndërkombëtare në fushatën zgjedhore ka në bazë të tij respektimin e dinjitetit të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore, lirinë e shprehjes dhe mendimit, pluralitetin, dialogun demokratik, tolerancën dhe respektin e ndërsjelltë, duke luftuar çdo formë të superioritetit të supozuar të një grupi ndaj të tjerëve, si dhe diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes për shkak të identitetit racor, gjinisë, përkatësisë, ngjyrës, fesë, bindjeve ideologjike dhe politike, prejardhjes krahinore, kulturës, moshës, gjinisë, apo orientimit seksual, aftësive ndryshe si dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit;

Duke rikujtuar faktin që, sidoqoftë, liria e shprehjes dhe mendimit nuk është e drejtë absolute dhe nuk duhet të ushtrohet në cënim me të drejtat e të tjerëve por në bashkërendim me to;

Duke ritheksuar rëndësinë themelore, për të zhvilluar një fushatë zgjedhore në mënyrë demokratike, të vendosur për të forcuar garancitë për zgjedhje të lira dhe të ndershme, larg çdo dukurie që deformon vullnetin e qytetarëve, si dhe në shmangie të çdo konflikti interesi, të udhëhequr nga nevoja për të kapërcyer klimën e mosbesimit midis partive konkurruese;

Duke qenë të vetëdijshëm se qëllimi i këtij Kodi është të vendosë rregulla të sjelljes për Partitë Politike, subjektet garuese dhe mbështetësit e tyre në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në një proces zgjedhor që duhet të garantojë zbatimin e standardeve më të larta demokratike;

Me qëllimin që ky Kod Sjelljeje të përbëjë një standard të detyrueshëm për palët që e negociojnë atë, nëpërmjet monitorimit të secilës palë, kryetarëve të partive të tyre, si dhe zyrtarëve, kandidatëve dhe anëtarëve të tyre, në masën që është e mundur dhe në rrethanat konkrete, çdo parti duhet që të ushtrojë kontroll mbi aktivitetet e saj dhe mbështetësve të saj si dhe të jetë përgjegjëse për shkeljet e Kodit nga mbështetësit e saj.

Biem dakord për sa vijon:

## **1. Parimet e përgjithshme**

1.1. Marrim përsipër të respektojmë dhe të zbatojmë parimin e shtetit të së drejtës dhe të veprojmë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor, kuadrin ligjor në fuqi dhe të gjitha parimet demokratike dhe liritë themelore të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht si dhe interesat qytetarëve shqiptarë;

1.2 Ne do të respektojmë dhe mbrojmë të drejtat e të gjithë subjekteve politike garues, kandidatëve si dhe votuesve shqiptarë, sikurse ato janë të garantuara nga legjislacioni në fuqi, duke shmangur çdo shkelje të dispozitave të ligjit zgjedhor apo veprave penale të parashikuara si vepra penale në Kreun X “Vepra Penale që Prekin Zgjedhjet e Lira dhe Sistemin Demokratik të Zgjedhjeve” të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë<sup>5</sup>, me qëllim kryerjen e një procesi zgjedhor të barabartë, të drejtë, të ndershëm dhe në përputhje me standardet më të mira të etikës;

1.3 Ne marrim përsipër që, para, gjatë dhe pas fushatës zgjedhore të kryejmë të gjithë aktivitetet e lejuara nga nenet 78 e në vijim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë<sup>6</sup> duke garantuar e një klimë dialogu demokratik, respektimi të pluralitetit d

he shumllojshmërisë së ideve e programeve, të lirisë së shprehjes dhe mendimit, tolerancës dhe respektimit të dinjitetit të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore pa asnjë diskriminim apo dallim të tyre për shkak të racës, fesë, prejardhjes etnike, kombëtarë, krahinore, bindjeve politike, gjinisë, orientimit seksual, moshës, aftësive ndryshe apo aspekteve të tjera të përkatësisë dhe statusit të tyre.

1.4 Do të jemi të ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka përkushtimi për të luftuar çdo formë të gjuhës së urrejtjes e cila mund të shfaqet në formën e diskriminimit për shkak të racës, etnisë, fese, prejardhjes, gjinisë së seksizmit, homofobisë, transfobisë, ksenofobisë, islamofobisë, antisemitizmit, antixhipsizmit dhe intolerancës, njësoj si në rastin e mohimit, banalizimit, justifikimit apo legjitimitetit publik të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit apo krimeve të luftës.

1.5 Ne marrim përsipër të shmangim përdorimin e çdo forme të gjuhës së urrejtjes dhe për qëllimet e këtij Kodi Sjellje, gjuha e urrejtjes do të kuptohet si “avokim, nxitje apo inkurajim në çfarëdo forme të denigrimit ndaj një personi apo grupe personash”, si edhe si “ngacim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj tyre”, dhe “justifikim i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e racës, ngjyrës, përkatësisë kombëtare apo etnike, prejardhjes, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit”.

---

<sup>5</sup> Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

<sup>6</sup> Ligj Nr. 10 019, Datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar

1.6 Pranojmë plotësisht përkufizimet dhe masat e sugjeruara në Rekomandimin Nr.15 Mbi luftën ndaj gjuhës së urrejtjes të Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) të Këshillit të Europës të publikuar në Strasburg më 21 Mars 2016<sup>7</sup>;

1.7. Marrim përsipër të kryejmë një proces zgjedhor ku të garantohen vlerat e gjithëpërfshirjes, përfaqësimit të drejtë dhe sigurimit të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët me të drejtë vote, përfshirë dhe grupet vulnerabël, të marginalizuara dhe të pamundura të cilat kërkojnë një asistencë specifike sipas nevojave të tyre.

1.8. Gjatë fushatës zgjedhore do të nxisim një mjedis paqësor zgjedhor, nuk do të mbështesim asnjë formë të dhunës fizike apo psikologjike ndaj votuesve, kandidatëve apo administratës zgjedhore dhe do të bëjmë thirrje për shmangien e saj;

## **2. Garantimi i integritetit dhe etikës në fushatën zgjedhore**

2.1. Ne marrim përsipër të zhvillojmë një fushatë zgjedhore të bazuar mbi konkurrimin e vlerave që reflektojnë programet, tezat dhe kandidatët respektivë të secilës parti politike duke respektuar, dinjitetin e konkurrentëve, e duke u përmbajtur që të mos përdoren fyerje personale;

2.2. Marrim përsipër të respektojmë të drejtën e secilës prej partive politike garuese dhe kandidatëve për të zhvilluar fushatën e tyre pa asnjë lloj pengese. Gjithashtu marrim përsipër që të mos nxisim aktivistët apo mbështetësit tanë për të penguar fushatën dhe procesin zgjedhor apo për t'u konfrontuar me asnjë person të partive rivale gjatë fushatës zgjedhore si dhe në ditën e zgjedhjeve, apo menjëherë me shpalljen e rezultatit.

2.3. Ne nuk do të përhapim informacione të rreme, të falsifikuara apo të marra në mënyrë të paligjshme në lidhje me kandidatët dhe subjektet e tjerë. Angazhimi për të mos përhapur informacione të pavërteta për kandidatët rivalë do të jetë i zbatueshëm edhe në rrjetet digjitale elektronike (hapësirat kibernetike) qoftë drejtëpërdrejtë për partitë nënshkruese të këtij kodi ashtu edhe për palët e treta të porositura prej tyre.

---

<sup>7</sup> <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech-alba/16809eb58e>

2.4. Ne angazhohemi plotësisht në respektimin e të gjitha parashikimeve ligjore të Kushtetutës, Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë<sup>8</sup> Kodit Penal<sup>9</sup> dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që garantojnë një proces të rregullt dhe të ndershëm zgjedhor, në respekt të barazisë së të gjitha subjekteve konkurrese pa cënuar lirinë dhe fshehtësinë e votës së qytetarëve.

2.5. Ne do të zhvillojmë një fushatë zgjedhore gjithëpërfshirëse në të cilën gratë, të rinjtë, komunitetet në pakicë, personat me aftësi ndryshe, dhe grupet e pambrojtura (ose më pak të mbrojtura), si dhe ato vulnerabël do të kenë mundësi të barabarta të marrin pjesë;

2.6 Ne do distancohemi nuk do të mbështesim asnjë përfaqësues politik i cili në retorikën e tij promovon, nxit apo lartëson çdo lloj forme denigrimi apo urrejtje , si dhe ngacmimin fyerjen, stereotipizmin negativ, stigmatizimin apo kërcënimin, apo më keq akoma përdor një gjuhë e cila jo thjesht nxit kryerjen e akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit, por ka dhe pritshmëritë e arsyeshme që ky përdorim të ketë këto efekte. Në rast të konstatimit të gjuhës së urrejtjes ne do të denoncojmë e do të distancohemi nga veprimi konkret pavarësisht se kë përfaqëson kandidati që ka përdorur këtë gjuhë, si dhe do t'u kërkojmë të gjithë aktorëve mediatikë që të mos transmetojnë në publik fjalime të tilla që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, denigruese apo fyese.

2.7 Me qëllim mbrojtjen e qytetarëve nga përhapja e COVID-19, një angazhim i posaçëm i yni dhe aktivistëve tanë do të jetë zbatimi i të gjitha masave që do të miratohen nga Institucionet Përgjegjëse si dhe institucionet e shëndetit publik.

2.8 Ne u bëjmë thirrje publikisht anëtarëve, aktivistëve dhe mbështetësve tanë që të përmbushin të gjitha angazhimet e mësipërme.

### **3. Monitorimi**

3.1. Ne marrim përsipër që të zbatojmë dispozitat e këtij Kodi Sjellje në të gjitha strukturat e partisë si dhe në aktivitetet e përditshme të partisë në çdo qark. Gjithashtu do të informojmë dhe

---

<sup>8</sup> Ligj Nr. 10 019, Datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës Së Shqipërisë, i ndryshuar

<sup>9</sup> Ligj nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar

udhëzojmë të gjithë anëtarët dhe aktivistët e partisë për angazhimet tona në zbatim të këtij Kodi dhe rëndësinë e parimeve të tij;

3.2. Pajtohemi dhe ftojmë misionet vëzhguese të Organizatave të Ndërkombëtare, Aleancën kundër Gjuhës së Urrejtjes, institucionet dhe organizatat që e përbëjnë atë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, organizatat shqiptare të Shoqërisë Civile, organizatat dhe grupet e Medias, që të monitorojnë dhe vlerësojnë përmbushjen e angazhimeve tona të parashikuara në këtë Kod;

3.3. Ne biem dakord të zbatojmë një mekanizëm shumë-palësh me qëllim zbatimin dhe monitorimin e këtij Kodi të Sjelljes, rezultatet e të cilit do të ndahen me të gjitha partitë me qëllim që të krijojnë një mekanizëm efektiv të zbatimit të këtij Kodi Sjellje në të ardhmen;

3.5. Ne jemi të ndërgjegjshëm për rreziqet që vijnë nga keqpërdorimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike (kibernetike) dhe medias në përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe shkeljeve të tjera të parimeve etike të përmendura në këtë Kod Sjelljeje dhe mbështesim çdo nismë për rritjen e sigurisë kibernetike si dhe etikës së strukturave mediatike qofshin këto të shkruara, audio-vizive apo on-line.

3.6. Ne marrim përsipër që të trajtojmë menjëherë dhe me përgjegjshmëri çdo ankesë për shkelje të dispozitave të këtij Kodi Sjellje dhe t'u përgjigjemi menjëherë e në mënyrën më efektive të mundshme shkeljeve të konstatuara.

Nënshkrimi i këtij Kodi Sjelleje do të kryhet në kopje të ndryshme me të njëjtën përmbajtje, nga personat e autorizuar të çdo partie politike që do ta miratojë atë dhe fleta me nënshkrimin e secilit subjekt do t'i bashkëngjitet tekstit të këtij Kodi, do të depozitohet pranë Aleancës kundër Gjuhës së Urrejtjes, e cila do ta depozitojë origjinalin pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe do t'u dërgojë të gjitha palëve nënshkruese një kopje të tekstit të Kodit të Sjelljes të miratuar dhe me nënshkrimet përkatëse.

\*\*\*

*(Në çdo fletë do të ketë emrin e subjektit politik që do të nënshkruajë tekstin dhe do t'i bashkëlidhen të gjitha fletët me nënshkrime tekstit më sipër)*